



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr 503 prot

Kucove me 03/02/2026

VENDIM

Nr. 3 datë 28.01.2026

Mbi Miratimin e Kritereve te Dhenies se Ndhimes Ekonomike nga Fond I Kushtezuar per Bllok-Ndhimen Ekonomike deri ne 6% dhe/ose me Fondet e Buxhetit Vendor.

Keshilli I Bashkise në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”, nenit 21 të ligjit nr.57/2019 “Për Asistencen Sociale ne Republiken e Shqiperise” kreu IV, pika 1 dhe 2 e VKM-se nr 597, date 04.09.2019” Per percaktimin e procedurave ,te dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e Kushtezuar per ndihmen ekonomike” “, Udhëzimit nr.5 dt.17.02.2017” Titulli I ndryshuar “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind” I ndryshuar me propozim te Drejtorise se Shërbimit Social,

VENDOSI:

1. 1. Te miratoje kriteret per dhenien e ndihmes ekonomike nga fondi shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike i cili eshte 6% e ketij fondi ,dhe mbi kete fond mund te bazohen edhe fondet e buxhetit vendor . Rritja e buxhetit te rasteve te bashkise con ne rritjen e mases perfituese per keto familje .Shuma aktuale sipas stuktures eshte bazuar ne masen e perfitimit te skemes se ndihmes ekonomike.

2. Kriteret sipas pikes numer 1 te ketij projekt-vendimi jane si me poshte:

a) Familjet e varfra te cilat nuk jane shpallur perfituese nga sistemi I pikezimit.

b) Familje me kryefamiljare gra qe jane te ve /te divorcuara/vajze /ne veshtiresi ekonomike dhe sociale.

c) Persona te paafte ,te vetmuar te cilet nuk kane asnje burim te ardhurash.

d) Familje me femije ne risk, referuar nga Njesia e Mbrojtjes se Femijve.

e) Persona te cilet jane te dhunuar ne familje ,trafikimit apo perdorues te substancave psiko-aktive.

f) Familje qe kane ne perberje anetare mbi moshe pune.

g) Familje te cilat splotesojne nevojat baze jetike qe penalizohen nga sistemi per mos plotesimin e kriterëve ligjore

e) Familje te cilat splotesojne nevojat baze jetike qe penalizohen nga sistemi per mos plotesimin e kriterëve ligjore.

i). Afati kohor I pageses se ndihmes ekonomike per secilin person qe do te paguhet nga fondet e bashkise nuk do te jete pa afat .

3. Dokumentat e aplikuesve te jene sipas VKMnr 597, date 04.09.2019 “Per percaktimin e procedurave ,te dokumentacionit dhe te mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike”

4. Masa e Ndhimes Ekonomike te perlogaritet sipas VKM nr.597, date 04.09.2019” Per percaktimin e procedurave ,te dokumentacionit dhe te mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimin te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike “

5. Ngarkohen per zbatimin e ketij vendimi Drejtoria e Sherbomit Social.

6. Ky vendim u miratua 23 vota pro, — vota kunder , — vota abstenim, ne presence te 23 anetareve te Keshillit Bashkiak.

KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK

Aleksander ZIU

